



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1171 Prot.

Durrës më, 28/7 / 2022

VENDIM

Nr 48, datë 28.07 2022

PËR

**"NDRYSHIM NË PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË VITIT 2022 NË
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës**

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren Financiare të Universitetit Aleksander Moisiu, Durrës, kontratën e nënshkruar me datë 17.02.2022 mes Fakultetit të Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, dhe ekspertës Blendis Bocari, respektivisht artikulli 29, shkresën nr. 585/1, datë 31.03.2022 e objekt "Kërkesë për kryerjen e pagesës në kuadër të aktivitetit të projektit "MISTRAL", Interreg Mediterranean", të ekspertës së jashtme Blendis Bocari", paraqitur nga drejtuesja e projektit Prof. As. Dr. Azeta Tartaraj, shkresën nr. 809, datë 18.5.2022 të drejtueses së projektit "MISTRAL", relacionin e hartuar nga Drejtoria e Administrimit Financiar, bazuar në Rregulloren dhe në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu " Durrës, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit një shtesë në planin e përdorimit të të ardhurave të vitit 2022, në vlerën 604 000 (gjashtëqind e kater mije) lekë.
2. Këto të ardhura do të përdoren për të parafinancuar shpenzimet e mbetura për mbylljen e projektit MISTRAL.
3. Shpenzimet e kryera do të rimbursohen në llogarinë e të ardhurave të Institucionit tonë nga fondet e disbursuara nga lideri, pas certifikimit të shpenzimeve të projektit
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.

Kryetare Senatit Akademik

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

